

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6362
E martë, 13 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Ambasadori amerikan
zotohet për vazhdimin e
mbështetjes për Gjykatën
Kushtetuese | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MALCOLM SIMMONS KA PËRFUNDUAR RAPORTIMIN
PARA KOMISIONIT PËR LEGJISLACION | FAQE 4-5

SIMMONSI NUK I BESON SPECIALES

- Gjykata Speciale ka për qëllim t'i
dënojë ish-komandantët e UÇK-së



- Në Gjykatën Speciale kam po aq besim sa
do të kisha në një gjykatë në Rusi apo në Iran

Ish-kryetari i Asamblesë së Gjiqtarëve të
EULEX-it, Malcolm Simmons, ka
drejtuar akuza të rënda ndaj Gjykatës
Speciale dhe misionit EULEX. Në
raportimin e tij para Komisionit për
Legjislacion, ai Specialen e ka krahasuar

me gjykatat në Rusi dhe Iran, duke
thënë se nuk beson fare në drejtësinë e
saj. Sipas tij, kjo gjykatë është njëetnike
dhe synon t'i dënojë vetëm
komandantët e UÇK-së. Misionin e
EULEX-it ai e ka akuzuar edhe për

korupsion, joprofesionalizëm dhe
ndikime politike. Para deputetëve,
Simmons ka thënë se misioni i BE-së
për sundim të ligjit synonte largimin e
"peshqve të mëdhenj" nga skena
politike

SERBIA DËSHIRON QË STRUKTURAT PARALELE T'I LEGALIZOJË PËRMES ASOCIACIONIT



Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka
deklaruar se Serbia i ka fuqizuar
strukturat paralele në Kosovë. Ai ka
vlerësuar se shteti serb këto struktura
po dëshiron t'i legalizojë përmes
Asociacionit të Komunave me Shumicë
Serbe. Derisa ka treguar për
përmbajtjen e takimit të fundit me

palën serbe në Bruksel, Bislimi ka thënë
që Serbia nuk ka kredibilitet moral ta
kërkojë formimin e këtij asociacioni
përderisa nuk i ka zbatuar obligimet që
ka marrë në këtë proces. Ndërsa
shoqëria civile i ka kërkuar Bislimi që
për këtë takim të raportojë në Kuvend
dhe jo në "Facebook" | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

BISLIMI, ASGJË NË
BASHKËPUNIM ME
ADMINISTRATËN E BIDENIT

F. 10

Shkruan: Faton
ABDULLAHU



AKTUALE



MEDIUMI SLOVEN: THAÇI
KA KËRKUAR TË DËRGOHET
NË ARREST SHTEPIAK NË
SLOVENI F. 5

MINISTRI SVEÇLA
PREMTON PËRKRAHJE
PËR ZJARRFIKËSIT F. 6

VARIANTI 'DELTA' I COVIDIT,
MSH-ja KËRKON NGA
QYTETARËT TË VAKSINOHEN F. 6

EKONOMI

SHEFI I BE-SË NË KOSOVË: NGA
VITI 2008 INVESTUAM MBI 100
MILIONË EURO NË TURIZËM F. 8

MË 19 KORRIK MBAHET
ANKANDI PËR BLERJEN E
LETRAVE ME VLERË F. 8

RRITEN ÇMIMET E KONSUMIT NË
KOSOVË F. 8

Së paku 49 persona të vrarë në përleshjet në Niger

NIAMEY, 12 KORRIK - Së paku 49 persona, përfshirë 40 sulmues të armatosur, janë vrarë në një përleshje në jugperëndim të Nigerit, pranë kufirit me Malin. Ministria e Mbrojtjes e Nigerit ka bërë me dije se rreth 100

“terroristë” me motoçikleta, të armatosur rëndë, kanë sulmuar fshatin Çoma Bangou.

Ministria e këtij shteti ka theksuar se “reagimi i shpejtë dhe i fuqishëm” i forcave të

mbrojtjes dhe sigurisë “bëri të mundur që të zbrapset sulmi dhe armikut t'i shkaktohen humbje të mëdha”.

Çoma Bangou ndodhet në rajonin Tillaberi, në kufi me Malin dhe Burkina Fason, një

zonë e njohur si “tre kufijtë”, e cila ka qenë rregullisht në shënjestër të grupeve radikale islamike.

Tillaberi është në gjendje të jashtëzakonshme qysh në vitin 2017.



Shkatërrohet grupi i krimit të organizuar që kontrabandoi qindra shqiptarë në ShBA dhe Britani

Agjencia Evropiane e Policisë EUROPOL ka njoftuar të hënën për 18 arrestime të kryera ditë më parë nga Policia Kombëtare e Spanjës si dhe për shkatërrim të një grupi të krimit të organizuar i cili ka qenë i përfshirë në kontrabandim të emigrantëve dhe mashtrim me dokumente. Pjesëtarë të këtij rrjeti është thënë të kenë ndërmjetësuar hyrjen e paligjshme të më shumë se 400 personave me shtetësi të Shqipërisë, në Mbretëri të Bashkuar dhe Shtete të Bashkuara.

Hetimi për këtë grup është thënë të jetë udhëhequr nga Policia Kombëtare e Spanjës në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Shqipërisë dhe zyrtarë për zbatim të ligjit dhe imigrim në Austri, Francë, Itali, Slloveni, Kosovë, Portugali, Mbretëri të



Bashkuar dhe Shtete të Bashkuara. Në ditën e aksionit, më 29 qershor të këtij viti, në Spanjë,

përveç 18 arrestimeve, janë bastisur edhe dy shtëpi dhe janë konfiskuar një varg dokumentesh,

elektronike, para të gatshme dhe disa lloje të drogës. Më tutje në njoftimin e EUROPOL-it është thënë se nga viti 2019 hetimet

kanë nxjerrë në pah rritjen e numrit të dokumenteve të falsifikuara nga imigrantët e Ballkanit Perëndimor. “Fazat e kaluara të hetimeve kanë çuar në shkatërrim të një grupi kriminelësh të identifikuar në një ishull të Karaibeve, i cili ka kontrabanduar imigrantë nga Shqipëria në ShBA, me dokumente të rreme”.

Aty, po ashtu, është përmendur se në dhjetor të vitit 2020 janë arrestuar edhe disa persona të cilët në Kosovë dhe Shqipëri kanë bartur dokumente false. “Katër dyqane printimi për dokumente false në Kosovë janë shkatërruar në mars të vitit 2021. Deri më tani hetimet kanë rezultuar me 46 arrestime, më shumë se 400 emigrantë të identifikuar në aeroporte dhe 1 000 dokumente të rreme të konfiskuara”.

Gjenerali amerikan në Afganistan e dorëzon komandën

KABUL, 12 KORRIK - Gjenerali amerikan në Afganistan, Austin Miller, i ka dorëzuar komandën gjeneralit Kenneth McKenzie, në një ceremoni zyrtare të hënën në Kabul. Ceremonia e së hënës përbën një tjetër gjest simbolik teksa luftës më të gjatë të Shteteve të Bashkuara po i vjen fundi.

Miller ka qenë në Afganistan nga viti 2018, mirëpo në maj presidenti amerikan Joe Biden e ka angazhuar për organizim të tërheqjes së trupave amerikane nga Afganistani deri në fund të gushtit. Prej muajit maj pjesa më e madhe

e 2 500 trupave amerikane janë larguar nga ky shtet, duke ua dorëzuar forcave afgane edhe bazën ajrore Bagram.

Nga kjo bazë forcat ndërkombëtare kanë kryer operacione kundër talibanëve dhe grupeve xhihadiste në dy dekadat e fundit.

Rreth 650 shërbyes amerikanë pritet të stacionohen në Kabul për ta ruajtur zyrën diplomatike të Uashingtonit, ku edhe është zhvilluar ceremonia e së hënës.

Zyrtarë të lartë afganë kanë marrë pjesë në këtë ceremoni nën masa të rrepta të sigurisë.

Forcat e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara kanë rrëzuar talibanët nga pushteti në tetor të vitit 2001. Talibanët kanë qenë duke strehuar atëbotë Osama Bin Laden dhe figura të tjera të Al-Kaidës të lidhura me sulmet e 11 shtatorit të po atij viti në Shtetet e Bashkuara.

Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se tërheqja amerikane tani është e arsyeshme pasi forcat amerikane janë siguruar që Afganistani nuk do të bëhet më bazë për xhihadistë të huaj që të kryejnë komplete kundër Perëndimit.



Konfirmohen dënimet e përjetshme për 10 anëtarë të Vëllazërisë Myslimane



KAJRO, 12 KORRIK (ER) - Gjykata e Apelit në Egjipt mbështeti dënimet e përjetshme për dhjetë anëtarë të Vëllazërisë Myslimane. Në mesin e të dënuarve është edhe udhëzuesi suprem i lëvizjes, Mohammad Badie. Dënimet e përjetshme - 25 vjet

burgim në Egjipt - janë shqiptuar fillimisht në vitin 2019. Dhjetë burrat janë dënuar për dhunë gjatë revolucionit të vitit 2011, që ka çuar në përmbysjen e diktatorit Hosni Mubarak. Gjykata, gjithashtu, ka shfajësuar tetë liderë të rangut

të mesëm të organizatës islamike.

Ata ishin dënuar më parë me 15 vjet burgim. Presidenti islamist Mohamed Morsi pasoi Mubarakun, por ushtria, e udhëhequr nga presidenti i tanishëm i Egjiptit, Abdel Fattah al-Sisi, e kishte rrëzuar

Morsin, pas protestave masive kundër sundimit të tij. Sisi e kishte shpallur të paligjshme Vëllazërinë Myslimane në vitin 2013 dhe pati burgosur mijëra mbështetës të saj. Vendimet e fundit të gjykatës janë finale dhe nuk mund të apelojnë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK BISLIMI KA TREGUAR SE ÇFARË ËSHTË DISKUTUAR NË TAKIMIN E FUNDIT NË BRUKSEL

Serbia dëshiron që strukturat paralele t'i legalizojë përmes asociacionit

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka deklaruar se Serbia i ka fuqizuar strukturat paralele në Kosovë. Ai ka vlerësuar se shteti serb këto struktura po dëshiron t'i legalizojë përmes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Derisa ka treguar për përmbajtjen e takimit të fundit me palën serbe në Bruksel, Bislimi ka thënë se Serbia nuk ka kredibilitet moral ta kërkojë formimin e këtij asociacionit përderisa nuk i ka zbatuar obligimet që ka marrë në këtë proces. Ndërsa shoqëria civile i ka kërkuar Bislimit që për këtë takim të raportojë në Kuvend dhe jo në "Facebook"



KDI-ja kërkon transparencë për dialogun

Këtë "raportim" të Bislimit në "Facebook" e kanë kundërshtuar përfaqësuesit e KDI-së. Menaxherja e projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për dialogun Kosovë - Serbi, Jeta Krasniqi, ka thënë se transparenca në "Facebook" nuk mjafton. Në profilin e saj në "Facebook", ajo ia ka shtruar disa pyetje zëvendëskryeministrit Bislimi. "Facebook" transparenca nuk mjafton. Ka ende shumë pyetje që kërkojnë përgjigje. Disa prej tyre janë: 1. Cilat janë marrëveshjet e identifikuar nga pala e Kosovës si të pazbatuara nga pala serbe? 2. Cilat janë marrëveshjet e identifikuar nga pala serbe si të pazbatuara nga pala e Kosovës, përveç marrëveshjes së asociacionit? 3. Çfarë ka kërkuar pala e Kosovës të bëhet me këto marrëveshje? A ka kërkuar rinegociim të tyre? Zbatim të tyre? Apo zhbërje të tyre? 4. Pra, çfarë do të ndodhë me marrëveshjet tashmë të arritura të dialogut?", ka shkruar Krasniqi. Kurse zyrtari tjetër i KDI-së, Eugen Cakolli, ka thënë se raportimi për dialogun duhet të bëhet në Kuvend e jo në rrjete sociale. "Raportimi për dialogun me Serbinë nuk do të duhej të kufizohej në 'raportim' nëpër rrjete sociale. Kuvendi i Kosovës është vendi ku së pari duhet raportuar e ofruar llogari!", ka shkruar Cakolli në profilin e vet në "Facebook".

EPOKA ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi, ka bërë me dije se Serbia nuk ka kredibilitet moral për ta kërkuar formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe përderisa ajo nuk i ka zbatuar obligimet që ka marrë në këtë proces.

Teksa ka treguar se çfarë është diskutuar rreth Asociacionit në takimin trepalësh që është mbajtur javën e kaluar në Bruksel, Bislimi ka thënë se Serbia nuk i ka shuar strukturat paralele, por i ka fuqizuar ato. "Në përgjigje, te pjesa e asociacionit, fillimisht kam konstatuar mungesën e kredibilitetit moral nga ana e Serbisë për të kërkuar çfarëdo implementimi nga pala e Kosovës për aq kohë sa ata vetë nuk kanë implementuar asnjë marrëveshje tek e cila nuk kanë parë përfitim për Serbinë. Pastaj i kam radhitur të gjitha strukturat

ilegale paralele të Serbisë në Kosovë si në politikë, siguri, arsim, shëndetësi, ekonomi dhe financa, dhe kam vërtetuar që me kohë Serbia jo që ka punuar për shuarjen e tyre, por i ka fuqizuar të njëjtat, përfshirë vendimet për emërime të nënshkruara nga individë kyçë si presidenti, kryeministri apo kryetari i parlamentit serb, dhe problemet me transferimin ilegal të parave për financim të tyre", ka shkruar Bislimin në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka treguar edhe qëllimin se pse Serbia po i fuqizon këto struktura. "Kam përmendur ndërmarrjet që operojnë ilegalisht në Kosovë, si dhe kryetarët e disa komunave të cilët në të njëjtën kohë kanë buruar nga zgjedhjet lokale në Kosovë dhe financohen nga buxheti i Kosovës dhe janë edhe të emëruar si kryetarë të 'institucioneve të përkohshme' të Serbisë në Kosovë. Kam konstatuar se këto struktura Serbia nuk është duke i ngritur

pa ndonjë arsye, dhe që ata kanë synim legalizimin e të njëjtave përmes asociacionit", ka vlerësuar ai.

Sipas Bislimit, vetëm kur Serbia të heqë dorë nga këto pretendime mund të diskutohet seriozisht për modalitetet më të përshtatshme për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të minoriteteve. "Po ashtu, kam shtuar se vetëm atëherë kur në Kosovë të mos funksionojë asnjë strukturë paralele serbe, kur nuk do ketë financim ilegal nga Serbia dhe kur askush në Evropë të mos e kontestojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, mund të ulemi dhe të diskutojmë seriozisht për modalitetet më të përshtatshme për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të minoriteteve, natyrisht, nëse edhe vetë minoritetet e konsiderojnë këtë të nevojshme, duke përmendur

faktin që pas hedhjes poshtë të asociacionit nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, asnjë serb i Kosovës nuk protestoi, por vetëm Beogradi reagoi", ka deklaruar ai.

Ndër të tjera, ai ka treguar edhe për temat e tjera që i ka ngritur pala serbe në këtë takim. "Takimi Serbi - BE është mbajtur të mërkurën në mëngjes dhe ka zgjatur afërsisht tri orë. Pala serbe ka ngritur pesë tema, në të cilat ka pretenduar që pala e Kosovës nuk i ka përmbushur obligimet e saj. Takimi trepalësh Kosovë-Serbi-BE është mbajtur të mërkurën me fillim në orën 13:30 dhe ka zgjatur 3:20 minuta. Pala jonë i ka shtruar sërish vërejtjet tona dhe pas nesh pala serbe ka ngritur pesë shqetësimet e saj, natyrisht me fokus kryesor tek asociacioni. Në përgjigjen time ndaj "shqetësimeve" të ekipit serb, kam adresuar edhe asociacionin", ka shkruar Bislimi.

Ambasadori amerikan zotohet për vazhdimin e mbështetjes për Gjykatën Kushtetuese



PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Gresa Caka-Nimani, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip S. Kosnett, të cilin e ka njoftuar për punën e deritanishme të kësaj gjykate si dhe për prioritetet e saj gjatë mandatit trevjeçar në krye të këtij institucioni.

Në njoftimin për media të Gjykatës Kushtetuese është thënë se Kosnetti është zotuar për vazhdimin e mbështetjes për Kushtetuesen. "Ajo shprehu mirënjohjen për përkrahjen që qeveria amerikane i ka ofruar

Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet projekteve të ndryshme për konsolidimin e saj institucional që nga themelimi dhe ka theksuar nevojën që kjo përkrahje të vazhdojë edhe në të ardhmen. Pasi që i uroi suksese znj. Caka - Nimani në detyrën e kryetares së gjykatës, ambasadori Kosnett u zotua për vazhdimin e mbështetjes së Shteteve të Bashkuara për Gjykatën Kushtetuese dhe për institucionet e tjera në vend, me qëllim të forcimit të gjyqësisë së pavarur dhe sundimit të së drejtës në Republikën e Kosovës", është thënë në njoftimin e Kushtetueses.



MALCOLM SIMMONS KA PËRFUNDUAR RAPORTIMIN PARA KOMISIONIT PËR LEGJISLACION

Simmons nuk i beson Speciales

**- GJYKATA SPECIALE KA PËR QËLLIM T'I DËNOJË
ISH-KOMANDANTËT E UÇK-së**

**- NË GJYKATËN SPECIALE KAM PO AQ BESIM SA DO TË
KISHA PASUR NË NJË GJYKATË NË RUSI APO NË IRAN**

Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, ka drejtuar akuza të rënda ndaj Gjykatës Speciale dhe misionit EULEX. Në raportimin e tij para Komisionit për Legjislacion, ai Specialen e ka krahasuar me gjykatat në Rusi dhe në Iran, duke thënë se nuk beson fare në drejtësinë e saj. Sipas tij, kjo gjykatë është njëetnike dhe synon t'i dënojë vetëm komandantët e UÇK-së. Misionin e EULEX-it ai e ka akuzuar edhe për korrupsion, joprofesionalizëm dhe ndikime politike. Para deputetëve Simmons ka thënë se misioni i BE-së për sundim të ligjit synonte largimin e "peshqve të mëdhenj" nga skena politike

Simmons ka drejtuar akuza të rënda në drejtëm të misionit EULEX. Ai ka deklaruar se misioni për sundim të ligjit i BE-së në Kosovë kishte për qëllim t'i hiqte nga skena politike ata që i cilësoi si "peshq të mëdhenj". "Pasi u emërova në këtë pozitë (kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it) u takova në Prishtinë me shefin e operacioneve civile, Kenneth Dean. Gjatë këtij takimi ai ma bëri shumë të qartë qëllimin e misionit që të largojë nga jeta politike personat që ai i përshkroi si 'peshq të mëdhenj'. Gjatë asaj bisede ai më tha. Po citoj: 'Pres t'i shoh gjyqtarët e EULEX-it që t'i dënojnë ata që akuzohen nga misioni'. Sipas tij, gjyqtarët e EULEX-it duhej të luanin rolin e tyre që misioni të kishte sukses. Për mua ishte e qartë se suksesi do të matej me numrin e dënimeve", ka deklaruar Simmons. Gjithashtu, Simmons ka bërë me dije se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishte prioritet për EULEX-in, duke synuar eliminimin nga skena politike të atyre që shiheshin si pengesë për këtë proces. "Ata që i dolën në rrugë procesit (të dialogut) u panë si pengues dhe duhej të

largoheshin nga pozitat udhëheqëse. Gjykatësit e EULEX-it ishin mjete për ta arritur këtë qëllim", ka deklaruar ai. Ish-gjyqtari i EULEX-it ka akuzuar këtë mision edhe për korrupsion. Ai ka deklaruar se misioni i BE-së asnjëherë nuk ka mohuar pretendimet e tij për korrupsion. Ai ka shtuar se nëse deputetët e Kuvendit të Kosovës duan të hapin hetim për EULEX-in, ai do të japë detaje lidhur me shumë raste. "Në EULEX ka persona të ndershëm dhe të hapur që e bëjnë punën e tyre dhe që kanë ardhur në Kosovë me qëllimin për të bërë mirë. Mirëpo, fatkeqësisht, ka shumë zyrtarë atje që dëshirojnë t'i mbushin xhepat. Ata e shohin këtë si mundësi për të bërë para dhe s'kanë interes për Kosovën dhe qytetarët e Kosovës", ka deklaruar ai. Simmons ka treguar se EULEX-i ka transferuar të dhëna në Serbi që kishin të bënin me mizoritë e pretenduara të kryera nga serbët gjatë luftës. Sipas tij, EULEX-i e dinte që Serbia nuk kishte vullnet për të hetuar dhe gjykuar këto raste. "Këto ishin hetimet mbi mizoritë e pretenduara nga serbët gjatë

procesin dhe rezultatin", ka deklaruar ai. Para deputetëve të Kosovës ai ka thënë se niveli i tij i besimit në Dhomat e Specializuara është i barabartë me besimin që ai e ka në gjyqësorin e Rusisë apo Iranit. "Në Gjykatën Speciale kam po aq besim sa do të kisha pasur në një gjykatë në Rusi apo në Iran. Ky është niveli i besimit që unë e kam në Dhomat e Specializuara të Kosovës", ka thënë Simmons. Ai ka treguar se i gjithë stafi i Speciales është përzgjedhur me kujdes në mënyrë që të mos ketë asnjë person që ka lidhje me Kosovën. "Nuk e kuptoj se si një gjykatë që shërben drejtësi në Kosovë nuk ka asnjë gjykatës të Kosovës që

shërben në Hagë", është shprehur ai. Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka thënë se ka vërejtje edhe në komunitetin ndërkombëtar karshi Gjykatës Speciale. "Ka shqetësime të mëdha në nivel të komunitetit ndërkombëtar në lidhje me nivelin e kompetencave të gjykatës dhe në lidhje se si po administrohet drejtësia", ka thënë Simmons.

EULEX-i synonte largimin e "peshqve të mëdhenj" nga skena politike

Në raportimin para deputetëve në Komisionit për Legjislacion,

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHINË, 12 KORRIK - Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, nuk beson se Gjykata Speciale mund të sjellë drejtësi. Gjatë një raportimi përmes një videolidhje para Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Simmons ka vlerësuar se kjo gjykatë është njëetnike dhe ka për qëllim t'i dënojë ish-komandantët e UÇK-së. "Është gjykatë njëetnike. Nuk është e interesuar për të arritur drejtësi. Është një gjykatë e cila e kontrollon

Mediumi sloven: Thaçi ka kërkuar të dërgohet në arrest shtëpiak në Slloveni

Prishtinë, 12 korrik - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar që në vazhdim të gjyqimit të tij nga Gjykata Speciale në Hagë, ku po akuzohet për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në luftën e fundit në Kosovë, të mbrohet në arrest shtëpiak dhe, meqë kërkohet një vend i tretë për të qëndruar, ai ka zgjedhur Slloveninë. Kështu ka raportuar mediumi sloven "Necenzurirano" në një shkrim ku flitet në detaje për procesin e ekstradimit të Thaçit në Slloveni, për ta vazhduar mbrojtjen nga arresti shtëpiak.

"Ky informacion na është konfirmuar nga disa burime brenda Sllovenisë dhe jashtë saj, po ashtu", kanë shkruar Primosh Cirman dhe Tomas Modic, dy gazetarët që kanë publikuar artikullin në mediumin "Necenzurirano".

Nga Specialja ende nuk janë deklaruar për këtë çështje, por dokumentet e Gjykatës që janë publike, tregojnë se Thaçi kishte kërkuar lirim me kusht në dhjetor të vitit të kaluar. Ai është pajtuar edhe me mundësinë që të jetë në arrest shtëpiak gjatë gjyqimit në një vend "që është një shtet i tretë dhe që nuk është në kufij me Kosovën".

Dokumentet e gjykatës, megjithatë, nuk tregojnë se cili është vendi i kërkuar nga Thaçi, por mediumi sloven shkruan se kanë informacione që

përzgjedhja e parë e ish-themeluesit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është Sllovenia.

Madje në artikull është thënë se Thaçi ka kontaktuar edhe me njerëz brenda qeverisë slovene për ta parë mundësinë e dërgimit të tij në Slloveni dhe për t'u siguruar se qeveria slovene do të bëhet garante, duke siguruar gjykatën se "Thaçi nuk do ta lë territorin sloven gjatë kohës sa gjyqohet".

Gjykata, gjithashtu, nuk është përgjigjur në pyetjen se nëse qeveria slovene e ka ofruar tashmë garancinë. Gazetës nuk i është përgjigjur as ministri i Punëve të Jashtme i Sllovenisë, Anze Logar.

Dokumentet publike të gjykatës tregojnë se gjykata në Hagë ia kishte refuzuar Thaçit kërkesën për mbrojtje nga arresti shtëpiak. Kjo kishte ndodhur në janar të këtij viti, meqë ishte arsyetuar se Thaçi mund ta shfrytëzojë rastin për të ikur. Gjithashtu, gjykata kishte pasur frikë se Thaçi mund të ndikojë te dëshmitarët. Sipas gjyqtarëve, Thaçi mund ta ushtrojë këtë ndikim edhe po që se mbahet në një shtet të tretë.

Por, gjykata mund t'i bëjë një rivlerësim kërkesë së Thaçit, meqë një nga gjyqtarët, gjermani Kai Ambos, në një opinion të tij ka shkruar se duhet "konsideruar seriozisht" kërkesa e Thaçit "nëse ai merr ndonjë ofertë nga ndonjë



vend i tretë si garantues për të".

Ai ka shkruar se "një ofertë e tillë do të ishte një argument i fortë për Thaçin", derisa shtonte se "Thaçi është i bindur se do të mund ta sigurojë këtë mbështetje nga një vend i tretë".

Sipas "Necenzurirano", kjo ka ndodhur në kohën kur Thaçi veçse kishte kontaktuar autoritetet slovene. Sipas procedurës, gjykata rishikon mundësitë e arrestit shtëpiak për Thaçin dhe shikon nëse janë bërë kushtet çdo dy muaj.

Pyetjeve për këtë lëvizje potenciale të Thaçit në drejtim të Sllovenisë nuk u është përgjigjur

as avokati i tij, amerikanë Gerogy Kehoe.

Mediumi sloven në një pjesë të tekstit ka shkruar edhe për afërsinë që Thaçi ka pasur gjithmonë me autoritetet slovene dhe me kryeministrin aktual sloven Janez Jansha. Ceket, gjithashtu, edhe vizita private që Janez Jansha i kishte bërë Thaçit në vitin 2011, kur ish-kryeministri i Kosovës ishte ende në opozitë. Për këtë zhvillim nuk kanë komentuar ende as institucionet në Kosovë. Ministria e Jashtme e Kosovës, po ashtu, nuk ka dhënë ende ndonjë koment.

Thaçi po mbahet në Hagë bashkë

me dy nga ish-bashkëthemeluesit e UÇK-së dhe bashkëpartiakët, Kadri Veseli e Jakup Krasniqi, derisa në Hagë janë edhe Rexhep Selimi e ish-komandantë të tjerë të UÇK-së. Akuza për të gjithë është e njëjtë. Sipas Prokurorisë në Speciale, themeluesit e UÇK-së kanë kryer krime në luftën e fundit, ose duke marrë pjesë ose duke i lejuar ato pasi ishin në zinxhirin komandues.

Të gjithë të akuzuarit i kanë mohuar kategorikisht akuzat që rëndojnë mbi ta. Ata janë deklaruar të pafajshëm në fjalimet e tyre të para në gjykatë.

/Albanianpost.com/

konfliktit. Këto dokumente përfshijnë jo vetëm detaje për krimet e pretenduara dhe të të dyshuarve, por edhe të dhëna personale të qytetarëve të Kosovës që ishin viktimë të këtyre krimeve dhe detaje të dëshmitarëve, shumica e të cilëve ishin shqiptarë, të cilët kanë pasur të drejtë që të mbrohen", është shprehur britaniku.

Ndikime politike në rastin "Kleçka" dhe në tri raste të tjera

Gjatë raportimit para deputetëve, Malcolm Simmons ka përmendur edhe raste konkrete në të cilat EULEX-i ka qenë i ndikuar politikisht. Ai ka thënë se në rastet për krime lufte, siç ishte rasti i njohur si "Kleçka" dhe "Drenica 1 dhe 2", ku ishin të përfshirë figura të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka pasur ndikime politike nga ana e misionit të BE-së.

Ai ka treguar se këto raste nuk do të duhej të zhvilloheshin asnjëherë sepse nuk ka pasur prova. "Rasti 'Kleçka', sipas meje, është rast që s'do të duhej të shkonte në gjykatë. Ishte rast që ka pasur shumë pak shanse që të arrijë sukses. Rasti është bazuar në dëshmi të vetëm një dëshmitari që ka pasur sëmundje mendore dhe ka vdekur para se të zhvillohej gjykimi. Dëshmia ka qenë kontradiktore jo vetëm sa iu përket shënimeve, por edhe në bazë të shënimeve të forenzikës", ka pohuar Simmons.

Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka cituar gjykatësin Charles Smith, i cili kishte thënë se duhen dënuar të akuzuarit në rastin "Kleçka". "Në katër raste të ndara ka pasur

pretendime se Charles Smith ka provuar të ndërhyjë në gjykime. Mund t'ju ofroj dokumente për të katër rastet. Nuk ishte vetëm gjyqtari Smith që donte të ndërhynte", ka treguar ai.

Ndër të tjera, në raportimin e tij ai ka folur edhe hakimin e email-it të tij, por edhe për iniciimin e masave disiplinore ndaj tij.

Që nga viti 2017, kur Simmons është larguar nga misioni i EULEX-it, ai ka bërë akuza të shumta për keqpërdorime dhe ndikime politike në procese gjyqësore që udhëhiqeshin nga EULEX-i. Ndërsa misioni i EULEX-it ka thënë se, pas akuzave që bëri Simmons në vitin 2017, një ekip i pavarur hetimor i udhëhequr nga një gjykatës në pension i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, ka hetuar pretendimet e tij, por se ai ka dështuar që t'i mbështeste akuzat që kishte ngritur.

Gjoshi: E vërteta e Simmonsit po i dhemb Albin Kurtit

Sekretari elektoral i PDK-së, Betim Gjoshi, ka komentuar raportimin para deputetëve të ish-kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmos. Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se Simmons ka folur edhe përkundër heshtjes së vazhdueshme dhe refuzimit të Albin Kurtit për ta dëgjuar. "Malcolm Simmos, kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, foli. Simmons foli edhe përkundër heshtjes së vazhdueshme dhe refuzimit të Albin Kurtit për ta dëgjuar. E vërteta po i dhemb Albin Kurtit, njeriu që dikur ia rotullonte makinat EULEX-it. Gjithçka që Albin Kurti ka bërë kundër EULEX-it ka qenë vetëm një shtihim i neveritshëm", ka shkruar ai.

EULEX-i i quan të pavërteta deklaratimet e Simmonsit

Ish-kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Malcolm Simmons, gjatë një raportimi para Komisionit për Legjislacion, ka thënë se misioni i EULEX-it nuk ishte mision "i sundimit të ligjit, por ishte mision politik". Po ashtu, ai ka thënë se EULEX-i kishte për qëllim të hiqte nga skena politike ata që i cilësoi si

"peshq të mëdhenj", ose ata persona që ishin parë nga ky mision si pengesë për dialogun Kosovë - Serbi. Ndaj deklaratimeve të tij ka reaguar EULEX-i. Sipas këtij misioni, deklarata e Malcolm Simmonsit e dhënë të hënën në Kuvend është një koleksion i hamendësimeve të pamenduara dhe të pabazuara, të

pavërtetave dhe mendimeve personale. "Duke e ditur se ai nuk mund të paditet për shpifje, meqë deklarata e Simmonsit është e mbuluar nga imuniteti i privilegjit parlamentar - ai është përfshirë në një fushatë të qëllimshme dezinformimi në lidhje me shkelje që pretendohet se kanë ndodhur

gjatë kohës së tij në EULEX të cilat ka për qëllim t'u shërbejnë motiveve dhe interesave të fshehta. Ne e shohim këtë si një përpjekje tjetër për ta diskredituar Misionin nga ata që janë të interesuar ta minojnë sundimin e ligjit në Kosovë si dhe të vet BE-së. Ky, po ashtu, është pasqyrim i pakënaqësisë duke e

ditur se ai nuk mund të paditet për shpifje, z. Simmons është angazhuar në një fushatë të qëllimshme dezinformuese në lidhje me keqbërjet që pretendohet se kanë ndodhur gjatë kohës së tij në EULEX, të cilat synojnë t'u shërbejnë motiveve të fshehta konkrete", është thënë në reagimin e EULEX-it.

Pesë raste të reja me Covid dhe gjashtë të shëruar në Kosovë

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë nuk është raportuar asnjë viktimit nga Covid-19. Po ashtu, MSh-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe janë regjistruar edhe pesë raste të reja të të infektuarve me këtë

virus. “Në 24 orët e fundit janë dhënë 6 361 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 260 955 doza të vaksinës. Deri më sot 67 578 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 1 050 testime, pesë qytetarë kanë

rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar gjashtë qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 463. Në total numri i rasteve aktive është 132”, ka njoftuar MSh-ja.



Varianti ‘Delta’ i Covidit, MSh-ja kërkon nga qytetarët të vaksinohen

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se të hënën është vaksinuar zëvendësministrja e kësaj ministrie, Dafina Gexha-Bunjaku. Me këtë rast, MSh-ja

ka theksuar se vaksinimi mbetet mënyra më efikase për t’iu kthyer jetës normale. “Të gjitha vaksinat që administrohen te ne janë të sigurta, efektive dhe mbrojnë kundër shfaqjes së

simptomave të rënda të sëmundjes të shkaktuar nga Covid-19”, ka njoftuar MSh-ja. Më tutje, kjo ministri ka treguar edhe për rrezikun në lidhje me përhapjen e variantit “Delta” të Covidit.

“Varianti ‘Delta’ i Covid-19 mund të dominojë në Evropë, prandaj është shumë e rëndësishme që sa më shumë qytetarë të vaksinohen gjatë kësaj periudhe të qëndrueshme të situatës

epidemiologjike që e kemi arritur së bashku. Vetëm përmes vaksinimit mund të mbrojmë veten, të afërmit tanë dhe të evitojmë një valë tjetër në vjeshtë”, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.



Ministri Sveçla premton përkrahje për zjarrfikësit

Prishtinë, 12 korrik (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të hënën në takim një delegacion nga Sindikata e Zjarrfikësve e Kosovës.

Ministri Sveçla është informuar hollësisht lidhur me shqetësimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen

zjarrfikësit gjatë kryerjes së detyrave të përditshme dhe përgjegjësisë për shpëtimin e jetëve të qytetarëve në rrezik.

Me këtë rast, ministri Sveçla ka thënë se e çmon lart profesionalizmin që kanë zjarrfikësit e Republikës së Kosovës, pavarësisht prej

kushteve të pavolitshme në të cilat punojnë. Me këtë rast, Sveçla është zotuar se zjarrfikësit do ta kenë mbështetjen e plotë nga Ministria e Punëve të Brendshme për zgjidhjen e statusit të tyre në mënyrë që të përmbushin me sukses detyrat dhe misionin e tyre.



Rreth 900 qytetarë të Deçanit dyshohet se janë helmuar nga uji i pijes

DEÇAN, 12 KORRIK (ER) - Mbi 800 qytetarë të Deçanit kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në këtë komunë pas dyshimeve se mund të jenë helmuar nga uji. Lajmin e ka dhënë kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, në një konferencë për media. Ai ka thënë se 884 qytetarë nga dita e shtunë e javës së kaluar e deri të hënën kanë kërkuar ndihmë mjekësore në QKMF. Me këtë rast, Ramosaj ka thënë se kanë marrë vendim që uji të mos

përdoret më. Ndërsa, sipas tij, rezultatet kanë treguar se kimikisht nuk ka probleme të ujit, por po i presin edhe analizat biologjike. “Ne kemi marrë vendim që uji të mos përdoret. Kemi ftuar prokurorinë, hetuesit, policinë e shtetit, IKShPK-në, kompaninë ‘Hidrotrini’ të cilët janë duke e kryer punën që të kemi një ekspertizë të saktë”, ka thënë ai.

Më tutje, Ramosaj ka thënë se kjo nuk është hera e parë që po raportohen probleme të tilla. Ai

është shprehur se është hera e dytë që po ndodh një gjë e tillë dhe se kjo bën që ata të kenë dyshime që këto probleme mund të jenë të qëllimshme.

Në lidhje me këtë çështje, kryetari Ramosaj ka takuar të hënën prokurorin Dorian Juniku, drejtorin e policisë nga rajoni i Pejës, Shaban Shala, drejtues të QKMF-së, komandantin e policisë në Deçan, përfaqësuesit e Institutit Rajonal të Shëndetësisë Publike, inspektorët komunalë dhe drejtuesit e “Hidrotrinit”.



Ambasada Amerikane: Autorët e dhunës seksuale në Kosovë të konsiderohen përgjegjës



Prishtinë, 12 korrik (ER) - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë ka kërkuar angazhim nga institucionet e Kosovës për, siç ka theksuar, vendosjen e drejtësisë

për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. “Është koha për t’i dyfishuar përpjekjet dhe për t’i mbajtur përgjegjës të gjithë autorët, pavarësisht prejardhjes, etnisë, lidhjeve politike”, ka thënë

Ambasada Amerikane në një shkrim publikuar në faqen e saj zyrtare në “Facebook”.

Javën e kaluar Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me dhjetë vjet burgim ish-rezervistin e

policisë serbe, Zoran Vukotiq, për kryerjen e veprës penale të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Kjo ka qenë hera e parë që dikush është dënuar për një krim të tillë nga gjykatat e Kosovës.

Sipas të dhënave të paraqitura nga institucionet, gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998/99 kanë qenë rreth 20 mijë raste të përdhunimeve seksuale nga pjesëtarë të forcave serbe.

Ambasadori spanjoll: Mosnjohja e Kosovës i shkakton probleme Spanjës

BEOGRAD, 12 KORRIK - Spanja nuk e njeh Kosovën, por kjo i shkakton probleme të konsiderueshme Madridit zyrtar ka thënë ambasadori spanjoll në Beograd, Raul Bartolome Molina. Në një intervistë për “Novostin” e Serbisë, Molina ka thënë se pozicioni i Spanjës në lidhje me Kosovën është politikë zyrtare shtetërore. “Mosnjohja e Kosovës bazohet në respektimin e rreptë të së drejtës

ndërkombëtare dhe parimeve themelore të saj, siç është respektimi i integritetit territorial, i cili është shkelur”, ka thënë Molina.

I pyetur nëse Spanjës po i ushtrohet presion për ta ndryshuar pozicionin e saj, Molina ka mohuar një gjë të tillë, duke thënë se qëndrimi i këtij shteti nuk është kapriçioz dhe arbitrar. “Megjithatë, është e

vërtetë që mosnjohja shkakton probleme të konsiderueshme për Spanjën, veçanërisht në kontekstin e organizatave ndërkombëtare”, ka thënë ai. Ndërsa kur është pyetur për t’i komentuar spekulimet e fundit se Spanja ka në plan të hapë zyrë ndërlidhëse në Prishtinë, Molina ka theksuar se kjo nuk do të supozonte ndryshimin e pozicionit spanjoll.



Rriten çmimet e konsumit në Kosovë

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Në Kosovë së fundmi është duke u vërejtur rritje e çmimeve të produkteve të konsumit. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit tregon për rritje të çmimeve për 2.4 për qind në muajin qershor krahasuar me qershorin e vitit

të kaluar. Ndërsa inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit, sipas ASK-së, ishte i pandryshuar në muajin qershor 2021 krahasuar me muajin maj 2021. Ngritje më e madhe në çmime është vërejtur te vajrat dhe yndyrat ushqimore. Ngritje e çmimeve është regjistruar

edhe te buka dhe drithërat, karburantet dhe te lubrifikantët për pajisjet e transportit personal, më pas te duhani dhe produktet e tjera. Sipas ASK-së, rënie e çmimeve vërehet te pajisjet telefonike dhe të ato të telefaksit. Agjencia e Statistikave e Kosovës analizon çmimet në 14 komuna të Kosovës.



GAP-i: Ka hendek të thellë në përfaqësimin gjinor në borde, burrat dominojnë në ndërmarrjet publike

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Instituti GAP ka publikuar të hënën raportin "Sfida 50/50: Zbatimi i kuotës gjinore në bordet e institucioneve publike". Me këtë rast është thënë se ekziston një hendek i thellë i përfaqësimit gjinor në borde dhe pozita menaxheriale të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura. Nga ky institut është thënë se ligji që është në fuqi që nga viti 2015 kërkon përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe të tjera. Sipas GAP-it, deri më tani institucionet publike kanë injoruar obligimin ligjor për përfaqësim të barabartë, duke interpretuar dispozitat e Ligjit për barazi gjinore si joobliguese. "Në mbledhjen e nëntë të Qeverisë së Kosovës për herë të parë u anulua një vendim për emërimin e anëtarëve të një bordi me arsyetimin se nuk ishte respektuar Ligji për Barazi Gjinore. Ky ligj, që është në fuqi prej vitit 2015, kërkon përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive,

gjyqësore dhe të tjera. Por, deri më tani institucionet publike kanë injoruar obligimin ligjor për përfaqësim të barabartë, duke interpretuar dispozitat e Ligjit për barazi gjinore si joobliguese", është në raportin e GAP-it. Më tutje, GAP-i ka theksuar se aktualisht ekziston një hendek i thellë i përfaqësimit gjinor në borde dhe pozita menaxheriale të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura. "Te ndërmarrjet publike mesatarisht 27 për qind e përbërjes së bordeve janë gra, ndërsa 28 për qind tek agjencitë e pavarura. Në pesë nga 14 ndërmarrjet publike gratë nuk janë fare të përfaqësuara. Në pozita menaxheriale të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura vetëm 33 për qind janë gra, ndërsa vetëm dy kanë kryeshefe ekzekutive nga 32 institucionet e përfshira në këtë hulumtim", është thënë në këtë raport.

Po në këtë raport Instituti GAP ka analizuar bazën ligjore për përfaqësim të barabartë gjinor në bordet publike dhe ka ofruar të



dhëna mbi përbërjen aktuale të bordeve të agjencive të pavarura dhe ndërmarrjeve publike dhe pozitat që do të jenë të lira në vitet e ardhshme. "Hulumtimi tregon se deri në fund të vitit 2021

do të përfundojnë mbi 50 mandate nëpër bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura. Andaj, Instituti GAP i rekomandon qeverisë dhe komunave që në

pozitat e lira ta kenë parasysh kuotën gjinore në mënyrë që ta përmirësojnë dhe avancojnë përfaqësimin e barabartë gjinor në vendimmarrje", është në raportin e GAP-it.

Shefi i BE-së në Kosovë: Nga viti 2008 investuam mbi 100 milionë euro në turizëm



PRISHTINË, 12 KORRIK - Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Thomas Szunyogu, ka vizituar të hënën biznesin "Lura Agroturizëm", i cili operon në Komunën e Novobërdës. Gjatë kësaj vizite ai ka qenë i interesuar ta shohë nga afër realizimin e disa projekteve të mundësuar nga Zyra e BE-së për këtë biznes. Me këtë rast, Szunyogu ka thënë se ka kënaqësinë që po viziton këtë biznes që, falë fondeve të dhuruara nga BE-ja, ka

ndihmuar zhvillimin e turizmit malor në Kosovë. Më tutje, shefi i BE-së ka bërë me dije se nga viti 2008 kanë investuar mbi 100 milionë euro për këtë sektor. "Kjo fermë është zgjeruar përmes ndihmës që ka dhënë Bashkimi Evropian. BE-ja përmes fondeve ka ndihmuar zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit bujqësor në Kosovë. Që nga viti 2008 kemi dhënë donacion mbi 100 milionë euro për këtë sektor", ka thënë

Szunyogu, duke shtuar se investimet kanë pasur ndikim të madh në këtë zonë. Po ashtu, ai ka thënë se është një periudhë e vështirë për të gjithë për shkak të Covidit.

Ndërsa Genc Buca nga "Lura Agroturizëm" është shprehur i lumtur për vizitën e shefit të BE-së dhe ka premtuar se nuk do të jetë ky investimi i fundit në provimin e turizmit. "Ne do të vazhdojmë ta promovojmë turizmin", ka thënë Buca.

Më 19 korrik mbahet ankandi për blerjen e letrave me vlerë

Prishtinë, 12 korrik (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 19 korrik 2021 do të mbahet ankandi i njëmbëdhjetë për vitin 2021 për blerjen e letrave me vlerë.

Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet 10-vjeçar në shumën prej 10 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin

për Borxhin publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (10 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për

blerjen e letrave me vlerë, të interesuarit të kontaktojnë ndonjëherë nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.



Komuna e Drenasit nis shqyrtimin e hartës zonale

DRENAS, 12 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me nënkryetarin e kësaj komune, Arben Shala, drejtoreshën e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Flutura Avdiu, drejtoreshën e kompanisë hartuese "Plan-A Consulting", Sadije Deliu, ka bërë hapjen zyrtare të shqyrtimit publik të "Projekt-dokumentit - Harta Zonale e komunës së Gllgocit 2021-2029".

Qëllimi i këtij prezantimi ishte që të zhvillohen konsultime dhe që të inkurajohet pjesëmarrja transparente e publikut për hartimin e këtij dokumenti të

planifikimit hapësinor që përmes grafikoneve, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Kosovës për një periudhë së paku tetëvjeçare.

Kryetari Lladrovci është shprehur se është i lumtur që gjatë qeverisjes së tij ka arritur të finalizojë dhe të miratojë dy dokumente më të rëndësishme të planifikimit hapësinor siç janë Plani Zhvillimor i komunës së Gllgocit 2020-2028 dhe Harta



Zonale e komunës së Gllgocit 2021-2029 ashtu siç përcaktohet në Ligjin nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor.

Me këtë rast, Lladrovci ka falënderuar kontribuuesit e hartimit të Hartës Zonale të komunës së Drenasit, ekipin

komunal të planifikimit, kompaninë e GIZ-it gjerman për mbështetje teknike, kompaninë hartuese "Plan-A Consulting", Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për dhënien e kontributit të jashtëzakonshëm gjatë gjithë këtij procesi.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik qytetarët e komunës së Drenasit do të kenë mundësi të japin vërejtjet, komentet dhe sugjerimet të cilat pastaj do të inkorporohen në dokumentin e Hartës Zonale të komunës për periudhën kohore 2021-2029. Shqyrtimi publik do të zgjatë 30 ditë që nga dita e hapjes.

Bahtiri, i shqetësuar për gjendjen aktuale të sigurisë në Mitrovicë

MITROVICË, 12 KORRIK (ER) - Nën kryesimin e kryetarit të komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, e në prani të drejtorëve të drejtorive komunale, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e bordit të drejtorëve, në të cilën janë shqyrtuar një varg çështjesh që kanë të bëjnë me këtë komunë.

Fillimisht, Bahtiri ka ngritur si shqetësim gjendjen aktuale të sigurisë në Mitrovicë, pas rasteve të fundit të përleshjes në mes të rinjve dhe vrasjes së një qytetari të Mitrovicës. Lidhur me këtë, kryetari Bahtiri ka thënë se menjëherë ka kontaktuar Drejtorinë Rajonale të Policisë në Stacionin Jugor si dhe nivelin



qendror, ku janë pajtuar që këto ditë të mbajnë takime të përbashkëta për të marrë hapa konkretë në këtë drejtim. "Këto

raste po ndodhin tash kur në Mitrovicë siguria dhe rendi e qetësia kishin marrë të mbarën dhe kur krimet kanë shënuar rënie

drastike, duke bërë që qyteti të jetë një nga më të qetët në vend. Por, pavarësisht prej këtyre rasteve, në bashkëpunim me policinë, nuk do të lejojmë të kemi pasiguri në Mitrovicë dhe grupe të njerëzve që prishin rendin dhe qetësinë publike", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Fidan Ademi, ka njoftuar ekzekutivin lidhur me formimin e komisionit komunal për plotësim/ndryshimin e Rregullores komunale për mbrojtjen e mjedisit 02/2010, respektivisht neni 15 për mbrojtje nga zhurma.

Më tutje, zyrtari kryesor financiar, Adem Fazliu, ka prezantuar raportin financiar për

gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, të hyrat vetjake, shpalesjen e buxhetit dhe shpenzimeve, investimet kapitale, obligimet e papaguara, lëndët e ekzekutuara nga Ministria e Financave - Departamenti i Thesarit. Lidhur me inkasimin e të hyrave vetjake për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, Fazliu ka bërë me dije se në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020, ka shënuar rritje prej 98.48-përqindësh, ndërsa sa i përket inkasimit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 në krahasim me planifikimin, komuna e Mitrovicës ka arritur të realizojë 63.47 për qind ose 1 482 618 euro.

Gjini shpalos punën gjashtëmujore të komunës së Gjakovës

GJAKOVË, 12 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, bashkë me kryesuesin e Kuvendit Komunal, Anton Shala dhe drejtorët komunalë, kanë mbajtur të hënën takimin e parë me qytetarë për vitin 2021, në të cilin kanë njoftuar për të arriturat gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti si dhe kanë shpalosur planet për muajt e mbetur të këtij viti.

Me këtë rast, kryetari Gjini ka thënë se, përkundër problemeve të përgjithshme të shkaktuara si pasojë e pandemisë Covid 19, gjashtëmujori i parë i vitit 2021 ka

qenë i suksesshëm për komunën e Gjakovës, "për faktin se gjatë kësaj periudhe është arritur që të përfundohen shumica e punëve publike të planifikuara, por ajo që është edhe më e mirë është se gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të të hyrave komunale, gjë e cila do të përkthehet me rritje të buxhetit dhe rritje të investimeve në periudhat e ardhshme", ka thënë ai.

Më tutje, Gjini ka rikujtuar se komuna që drejton ka një plan të investimeve, të ndërtuar mbi prioritetet dhe të bazuar në



gjendjen në terren dhe nevojat më emergjente të qytetarëve. Në këtë drejtim, ai ka përmendur angazhimet konkrete në kryerjen e infrastrukturës rrugore, me qëllimin e vetëm që brenda vitit 2022 të mos mbetet asnjë rrugë e pa asfaltuar në Komunën e Gjakovës. Ai ka përmendur edhe projektet e ujësjellësit, tashmë pothuajse të përfunduara në tërë komunën, pastaj ndërtimin e sistemit të ngrohjes qendrore pothuajse në të gjitha shkollat e komunës, ndërtimin e disa çerdheve për fëmijë e të tjera.

Fillon asfaltimi i rrugës në fshatin Carrallukë të Malishevës

MALISHEVË, 12 KORRIK (ER) - Komuna e Malishevës ka njoftuar se të hënën ka filluar asfaltimi i një rruge të gjatë rreth dy kilometra në fshatin Carrallukë, e cila, sipas kësaj komune, ka rëndësi të madhe

për banorët e këtij fshati. Në fillimin e asfaltimit të kësaj rruge ishte i pranishëm drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, me bashkëpunëtorë, ku me këtë rast ka uruar banorët e fshatit Carrallukë të cilët prej

tani do ta kenë më të lehtë qarkullimin e tyre rrugor. "Kjo rrugë është e gjatë rreth dy kilometra dhe do t'u shërbejë fshatarëve. Tashmë infrastruktura rrugore, jo vetëm në fshatin Carrallukë, por në

shumicën e fshatrave të komunës së Malishevës, është në përfundim e sipër. Pra jemi në fazën më dinamike të punëve dhe projekteve infrastrukturore për vitin 2021", ka thënë Morina.



Bislimi, asgjë në bashkëpunim me administratën e Bidenit



Shkruan: **Faton ABDULLAHU**

Nëse lexohen me vëmendje kushtet të cilat i listoi zëvendëskryeministri i Kosovës, z. Bislimi, në shkrimin e tij të publikuar në "Facebook" mbi dialogun me Serbinë, përfundimi

përmbledhtazi është se kjo qeveri do të dialogojë me Serbinë vetëm nëse më parë Serbia de facto e njeh Kosovën dhe kur asnjë nga pesë shtetet në Evropë nuk e konteston Kosovën shtet. Ja më konkretisht çfarë thotë z. Bislimi në këtë drejtim:

"... po ashtu kam shtuar se vetëm atëherë kur në Kosovë të mos funksionojë asnjë strukturë paralele serbe; kur nuk do ketë financim ilegal nga Serbia dhe kur askush në Evropë të mos e kontestojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, mund të ulemi dhe diskutojmë

seriozisht për modalitetet më të përshtatshme për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të minoriteteve..."

Në rregull. Por si do të detyrohen ta bëjnë këtë Serbia dhe Evropa. Kush do t'i shtyjë ato ta bëjnë një gjë të tillë që nuk e kanë bërë deri sot. Si të shtyhet Serbia të heqë dorë nga përfshirja në veri të Kosovës dhe si të detyrohen pesë shtetet e Evropës të na njohin. Nëse jo me dialog, atëherë duhet të ekzistojë një mundësi tjetër. Për këtë duhet të ketë menduar qeveria Kurti. Apo ajo është aq e fortë saqë,

thjesht, mund ta refuzojë dialogun dhe askush s'mund ta shtyjë që të dialogojë me Serbinë. Kjo pyetje na çon te përfundimi se duhet një plan B për këtë qasje, përndryshe çdo gjë duket më shumë se nonsens. Apo do të ndodhë diçka tjetër.

P. sh., që qeveria Kurti (dhe kjo është aq reale sa kushtet e Bislimit) të ndikojë në Luginën e Preshevës. Të ndikojë ashtu që qeveria Kurti të krijojë dhe financojë struktura paralele shqiptare në Luginë dhe t'i shtyjë së paku pesë shtetet e Evropës ta çnjohin Serbinë.

Dhe vetëm pas kësaj të fillojë dialogu i të barabartëve. A janë këto nonsense politike? Patjetër që po. Por këto politika tashmë zyrtare të Kosovës nuk po vijnë nga refuzimi i dialogut që po e bën qeveria Kurti. Jo. Këto po determinohen tash sa kohë nga moskoordinimi i ideve, propozimeve dhe politikave të kësaj qeverie me administratën e Bidenit. Qeveria Kurti po e fut përnjëmend Kosovën në një epokë të re, ku ShBA-ja nuk është ajo që ishte që nga paslufta, partnere kryesore e Kosovës, sidomos në raport me Serbinë.

A mund të jenë politikanët shenjtorë?

Nga **Sophia DEBOICK**

Babai themelues i Bashkimit Evropian mund të fitojë së shpejti një aureolë hyjnore. Robert Schuman ishte burrshtetasi francez i lindur në Luksemburg që themeloi Këshillin e Evropës dhe ideoi planin e pasluftës për themelimin e një autoriteti të vetëm evropian të çelikut dhe qymyrit.

Ai hodhi themelet për nënshkrimin e Traktatit të Romës në vitin 1957 dhe krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian vitin që pasoi. Ndërkohë, ai u zgjodh kryetari i parë i Parlamentit Evropian. Muajin e kaluar Papa Françesku njohu "virtutet heroike" të Schuman, duke i dhuruar politikanit katolik titullin "I nderuar", e para nga tri fazat drejt shenjtërimit të tij të plotë.

Deklarata e Schumanit, e nënshkruar më 9 maj 1950, datë kur festohet Dita e Evropës, synonte të lidhte burimet thelbësore të Gjermanisë dhe të Francës për prodhimin e armatimeve, duke e bërë çdo konflikt në të ardhmen midis fuqive të mëdha evropiane "jo thjesht të paimagjinueshëm, por materialisht të pamundur".

Schuman kishte parë më sytë e vet shkatërrimet që solli lufta, ndaj plani i përqendruar te qymyri dhe çeliku ishte një mision për vëllazërinë universale. Konflikti në Evropë e kishte formësuar identitetin e Schumanit.

Babai i tij lindi në Alsace-Lorraine franceze, por u bë një shtetas gjerman kur rajoni u

aneksua gjatë Luftës Franko-Prusiane të viteve 1870-71. Schuman lindi 15 vjet më vonë me shtetësi gjermane, por kur Alsace-Lorraine iu rikthye Francës pas Luftës së Parë Botërore, ai mori shtetësinë franceze.

Pasi u diplomua për drejtësi, ai luajti një rol kryesor në riintegrimin e rajonit në kornizën legislative franceze si anëtar i Moselle, Lorraine, në parlamentin francez, duke nisur nga viti 1919. Kur Evropa u përfshi sërish nga lufta, Schuman ishte një ministër i ri në qeverinë franceze.

Ai refuzoi të shërbente kur u vendos regjimi kukull i marshallit Pétain dhe u angazhua me Rezistencën Dranceze. U arrestua nga Gestapo në fundin e vitit 1940 dhe u burgos për shtatë muaj. Nazistët planifikuan ta dërgonin në kampin e përqendrimit në Dachau, por ai arriti të arratisë në zonën e lirë franceze dhe të qëndronte i fshehur, shpesh nëpër kisha dhe manastire deri në fundin e luftës.

Schuman mbajti disa pozita ministrore duke nisur nga viti 1946. Ai e formuloi Deklaratën Schuman gjatë mandatit ministër i Jashtëm midis viteve 1948-1952, pasi kishte mbajtur për dy periudha të shkurtra pozitën e kryeministrit të Francës.

Ngjashëm me rolin e tij në projektin evropian, Schuman ishte një figurë kryesore edhe në themelimin e NATO-s, gjë që pasqyroi fjalët e Deklaratës së tij: "Paqja në botë nuk mund të mbrohet pa përpjekje kreative proporcionale kundër rreziqeve

që e kërcënojnë atë".

Vlerësimi i kontributit të Schumanit nga Vatikanit ka shumë kuptim nën dritën e kritikave të forta të Papa Françeskut ndaj Brexitit dhe minimin që i ka bërë ai projektit evropian.

Vetëm një muaj para referendumit mbi Brexit, Papa mori çmimin "Karli i Madh" për unitetin Evropian - një çmim i fituar nga vetë Schuman në vitin 1958 - dhe në fjalën e rastit ai vuri re se "dëshira për të krijuar unitet duket se po zbehet", duke folur me tone kritike ndaj atyre që "mendojnë të ndërtojnë gardhe". Në komentet e bëra menjëherë pas referendumit pro Brexit, Papa e vuri theksin te rëndësia e vazhdimin të garantimit të "bashkëjetesës në të gjithë kontinentin evropian". Ndërsa enciklika e vitit të kaluar "Fratelli Tutti" (Të gjithë vëllezër), theksonte, ndër të tjera, se "në shumë vende hiperbola, ekstremitet dhe polarizimi janë shndërruar në mjete politike".

Në fjalimin e mbajtur me rastin e marrjes së çmimit, në të cilin ishin të pranishëm shumë udhëheqës të BE-së, Papa kritikoi dobësitë e BE-së, sidomos në trajtimin e krizës së emigrantëve. "Unë ëndërroj një Evropë ku të jesh emigrant nuk është një krim" - tha kreu i Vatikanit, duke theksuar se gjithsesi vazhdon të besojë te projekti evropian, siç u konceptua për herë të parë nga Schuman dhe të tjerët: Etërit themelues të Evropës ishin lajmëtarë të paqes dhe profetë të së ardhmes. Sot më shumë se kurrë vizioni i tyre na frymëzon të ndërtojmë ura dhe të shembim mure".

Nuk është për t'u habitur që Papa po mbështet ngritjen e Schumanit në pedestal. Dhe nuk është dhe aq befasisëse sa mund të duket në pamje të parë, që jeta e një politikani të përputhet me përkufizimin e Kishës për shenjtërinë.

Papa Françesku ka thënë se edhe pse shpesh denigrohet, "politika mbetet një vokacion i lartë dhe një nga format më të larta të bamirësisë për sa kohë që ajo synon të mirën e përbashkët". Vetë Schuman e cilësoi bashkimin e Evropës si realizim përfundimtar i projektit të Kishës Romake për ta bashkuar të ashtuquajturin krishterim.

Edhe para "të nderuarit Robert Schuman" ka pasur precedentë për individë të shquar që arritën të dilnin të panjollësuar nga politika e egër, për t'u vendosur në rrugën e shenjtërisë. Koncepti i Schumanit mbi një komunitet mbikombëtar evropian ishte formësuar pjesërisht nga libri "Utopia" i Thomas More që, siç tha politikani francez, "në mënyrë abstrakte krijoi kornizën për sistemet që ishin të zgjuara dhe bujare".

Dhe More është politikani shenjtor më i famshëm nga të gjithë. I kanonizuar në vitin 1935, martirizimi i tij, për shkak të mbrojtjes së palëkundur të besimit të tij katolik, e bëri atë të përshtatshëm për shenjtërim. Persekutimi i dhunshëm që kreu ndaj heretikëve protestantë nuk ishte kurrfarë pengese për procesin e shenjtërimit.

Kohët e fundit Julius Nyerere, presidenti katolik i Tanzanisë me shumicë myslimane, për më shumë se 20 vjet, dhe babai themelues i kombit pas shpalljes

së pavarësisë në vitin 1961, është paraqitur kandidat për shenjtërim të mundshëm.

Ai është ende në pjesën e poshtme të shkallës dhe titulli i tij "Shërbëtor i Zotit" tregon se po hetohet përshtatshmëria e tij për t'u shpallur shenjt. Mbrojtja prej tij e vlerave të familjes, komunitetit dhe të varfërve, u përshtatet mesazheve të Papa Françeskut, por është e paqartë nëse abuzimet me të drejtat e njeriut të regjimit që ai drejtoi, përfshirë arrestimet dhe burgimet e shumta pa gjyq, do të pengojnë procesin e shenjtërimit të tij.

Me rënien e frekuentimit të kishave në Perëndim, Kisha Katolike ka një interes të madh në vlerën marketuese të figurave si Nyerere në rajonet ku shtrihet vitaliteti i saj i ardhshëm. Por shenjtorë të tillë politikanë janë të rrallë, dhe dëshmorët dhe ata që kanë bërë një jetë fetare zyrtare, kanë shumë më tepër gjasa të marrin vëmendjen si shenjtorë të mundshëm. Dhjetë individë të tillë - siç ishin murgeshat e Kongregatës së Motrave të Shën Elizabetës në Poloni, të vrara nga Ushtria e Kuqe sovjetike në vitin 1945, dhe të konsideruar si të martirizuar "për shkak të fesë" - u lumturuan nga Papa në të njëjtën kohë kur Schuman u shpall "I nderuar".

Njohja e sakrificës së viktimave të luftës në Evropë, së bashku me kontributet e njeriut që u zotua ta sigurojë paqen e përhershme, është një kujtesë e miliona tragjedi individuale që nxitën projektin e Schuman 70 vjet më parë. Ajo tregon se çfarë është, në fakt, në rrezik kur flasim për unitetin evropian. / *The New European/ bota.al/*



Bernard Quaritch Ltd

Dyqani shekullor i antikuarëve: Kemi pasur edhe vepra për Skënderbeun

Bisedoi Andreas DUSHI

Bernard Quaritch Ltd është një kompani në Londër e cila, qysh prej vitit 1847 blen dhe shet libra të rrallë, dorëshkrime apo të tjera materiale të shkruara apo të shtypura, që i përkasin shekujve të shkuar. Biseda në vijim, realizuar me drejtorin aktual të Bernard Quaritch Ltd, z. Donovan Rees, nuk synon vetëm t'i paraqesë lexuesit diçka e cila nuk ekziston në Shqipëri, por edhe të tregojë se kushdo merret me librin është njëfarëloj misionari. Ideja se librari është veç një shitës, bibliotekari veç një nëpunës, botuesi veç një biznesmen etj., duhet të ndryshojë. Faji për këtë perceptim nuk është i publikut në më të shumtën e rasteve, por i vetë njeriut që merret me librin. Ajo çka qysh shekullin e shkuar u tha nga filozofët e Shkollës së Frankfurtit se kultura po kthehet në argëtim i cili në të njëjtën kohë duhet edhe të prodhojë të ardhura, çdo ditë e më tepër konkretizohet në realitetin tonë. Vitinat e dyqaneve mbushur me tituj që përçojnë drithërima dhimbjesh e tragjedishë; bibliotekarë që i punojnë dhe botojnë tituj të tillë; botues që i botojnë këto tituj dhe i promovojnë me madhësi, bazuar veç në ndikim tregtar që

ata kanë: *më i shitur!*

Prandaj, kjo bisedë është e para e një cikli të çrregullt bisedash me të kushtuarit në tempullin e librit, jashtë atdheut tonë gjeografik, si trokitës në portën e ngushtë të derës së mësonjëtores që gjendet në atdheun tonë mendor.

A. D: Themeluesi juaj, Bernard Quaritch, ishte një nga bibliofilët më të njohur dhe njëherazi, edhe një koleksionues librash duke krijuar kështu një kompani për shitjen e librave të rrallë. Si vazhdoi misioni i tij pas vdekjes?

D. R: Pas vdekjes së Bernard Quaritch, në 1899, kompania u mbajt nga familja e tij për një 72 vjeçar tjetër, para se të shitej përfundimisht, por që në vitin 1971 ka vetëm dy pronarë – kushdo qëndron me Quaritch për një kohë tepër të gjatë! Ne i qëndrojmë besnikë shpirtit të kompanisë, ashtu sikurse u krijua nga Quaritch, me ndershmëri, saktësi dhe cilësi, gjëra të cilat janë thelbësore për atë që bëjmë, po ashtu edhe në një perspektivë ndërkombëtare. Për më tepër informacion rreth historisë sonë, mund të kërkoni në website-n e kompanisë.

A. D: Sa libra të rrallë zotëroni? Në çfarë gjuhë janë pjesa më e madhe e tyre?

D. R: Është e vështirë të jap një



Donovan Rees – Drejtori aktual i Bernard Quaritch Ltd

numër të saktë të librave që kemi, për shkak të materialit të parregjistruar të koleksionit, por mund të kemi rreth 8000 – 10000 libra stok. Nganjëherë, ndonjë librari e madhe vjen dhe e shton numrin në mënyrë të konsiderueshme. Librat i kemi në aq shumë gjuhë për të cilat ka edhe treg të mirë, por gjuhët më të zakonshme janë Anglisht, Latinisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht dhe Rusisht; përveç tyre, ne mbajmë gjithashtu edhe

materiale në gjuhën Kineze, Arabe, Gjermane etj..

A. D: Në çfarë mënyre i keni siguruar ato libra? Janë njerëzit ato të cilët jua japin, apo i gurmoni në "mënyrat tuaja misterioze"?

D. R: Ne i sigurojmë materialet në dy mënyra: publikisht dhe privatisht, d.m.th. nga ankande dhe agjentë shitjesh, po ashtu nga individë privatë që zotërojnë materiale për të shitur. Shpesh, koleksionistët të cilët janë drejtuar tek ne për të krijuar libraritë e tyre gjatë shumë viteve, në fund janë rikthyer për ndihmë, që t'i shesin librat e tyre. Nëse një klient kërkon një libër të caktuar, ne mund ta ndihmojmë duke e lidhur me dikë për të cilin e dimë se ka kopje që duan t'i shesin.

A. D: A keni ndonjë libër Shqip ose libra për Shqipërinë apo Ballkanin?

D. R: Fatkeqësisht, nuk kemi shumë materiale nga Shqipëria ose Ballkani sepse klientët tanë nuk i kanë kërkuar, por për shembull, kemi një dorëshkrim të një fjalori Arabisht – Turqisht, të shkruar në Margus (Po arevac në Serbinë e ditëve të sotme), një bibliografi librash të shekullit të nëntëmbëdhjetë në Dalmaci dhe Kroaci dhe një vepër të hershme të shtypur në Dubrovnik. Më

herët kemi pasur një numër të konsiderueshëm librash udhëtimi për Adriatikun Lindor, dhe vepra për Skënderbun.


A. D: Gjatë karantinës së Covid-19, si ia keni arritur të "mbijetoni"? Dhe gjithashtu, në vijim të kësaj pyetjeje, a ofroni blerje online dhe transport në mbarë botën?

D. R: Po, kemi vazhduar të operojmë edhe gjatë pandemisë, ndonëse për fat të keq dyqani ynë fizik aktualisht është i mbyllur për vizitorët; në një situatë normale, do të merrnim rregullisht pjesë në panairë librash ndërkombëtarë, por për fat të keq, gjithçka është bërë online për këtë vit. Në website, sikurse është edhe ABE, listojmë shumë produkte që janë stok (edhe pse jo të gjitha) dhe shpërndajmë rregullisht kataloge nëpërmjet e-mail, të cilët gjithsesi mund të shkarkohen nga website ynë.

Gjithashtu, ne publikojmë një gazetë të shkurtër me 20 – 25 risi në të gjitha fushat – ju [për ta marrë] mund të rregjistroheni në website-n tonë.

Sigurisht ne kryejmë dërgesa në të gjithë botën dhe pranojmë pagesa në GBP, USD dhe EUR, ndonëse në disa shtete mund të ketë detyrime doganore.

*Përktheu nga anglishtja:
Marinela Mundija/exlibris.al/*



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Mançini: Italia e meritoi fitoren, Donnarumman është më i miri në botë

LONDËR, 12 KORRIK - Italia në "Wembley" mposhti Anglinë pas goditjeve të 11-metërshave duke fituar për herë të dytë në histori një kampionat evropian dhe trajneri Roberto Mançini i ka meritat më të mëdha për këtë sukses. Ai ka thënë se skuadra përfaqësuese e Italisë e ka merituar fitoren. "E merituar fitoren. Goli i tyre na krijoi probleme në 15 minutat e para. Ishte zhgënjyese të arrinim te penalltitë dhe të vuanim kaq shumë. Jemi të lumtur për të gjithë italianët brenda dhe jashtë vendit. Ende nuk e kuptojmë se çfarë

kemi bërë. Është gëzim i madh. Kemi bërë diçka të pabesueshme. Ishin 50 ditë të vështira, por kaluam mirë së bashku, pa probleme të mëdha, veçanërisht në marrëdhënien e djemve këto ditë. Ata janë të gjithë djem të mirë dhe kanë krijuar diçka të pandashme për të ardhmen", ka deklaruar Mançini. Trajneri italian nuk kishte sesi të mos vlerësonte portierin Donnarumman për paraqitjen në finale dhe jo vetëm, ndërkohë që theksoi se fati i detyrohej diçka dhe e mori shpërblimin në finalen ndaj Anglisë. "Luajta me ekipin më

të mirë të 21-vjeçarëve të Italisë në 'Wembley', madje humba penallti dhe nuk fituam. Mendoj se fati më detyrohej diçka. Të kesh Donnarumman në skuadër është fat i madh. Ai është më i miri në botë. Lajm i mirë që është një mes nesh. Përfaqimi me Viallin? Jemi miq që një jetë. Kemi bërë diçka që askush nuk e kishte bërë më parë. Evropiani i fundit ishte fituar në vitin 1968 dhe ne e sollëm Kupën në Itali. E pabesueshme. Pastaj u ngazëllyem, edhe pse tashmë jemi plakur", ka shtuar Mançini.



Southgate, pas humbjes në finale: Penalltitë janë përgjegjësia ime



LONDËR, 12 KORRIK - Gareth Southgate, pas humbjes me penallti ndaj Italisë në finalen e Evropianit, e mori përsipër përgjegjësinë e penalltive dhe nuk e fshehu zhgënjimin pas kësaj humbjeje. "Jemi shumë të zhgënjyer. Lojtarët ishin fantastikë. Dhanë gjithçka në këtë mbrëmje. Herë pas here luajtën shumë mirë. Nuk e mbajtëm dot topin mjaftueshëm, veçanërisht në fillim të pjesës së dytë, por nuk ka asnjë fajtor për këtë. Në dhomat e zhveshjes ishte një situatë shumë e dhimbshme.

Penalltitë janë përgjegjësia ime. I zgjodha unë goditësit e penalltive bazuar në atë që kishim bërë në stërvitje. Kemi fituar së bashku dhe na takon të gjithëve përgjegjësia e humbjes. Gabimi te penalltitë më takon mua. E nisëm mirë ndeshjen por, fatkeqësisht, djemtë nuk arritën të bënin më shumë", ka thënë Southgate. "Lojtarëve u thashë se jemi të gjithë bashkë, që kanë qenë të pabesueshëm dhe ishte kënaqësi puna me ta. I dhanë vendit kujtime të pabesueshme dhe kjo mbrëmje do të jetë e

vështirë për të gjithë ne. Ndhemi të zhgënjyer, sepse mundësitë për të fituar të tillë trofe janë shumë të rralla në jetë. Duhet të jenë shumë krenarë për veten. Saka është superdjallë. Të gjithë e duan atë. Bëri një turne të pabesueshëm. Ai është yll dhe do të vazhdojë të jetë i tillë. Luajti shumë mirë kur hyri në fushë. Duhet të jemi pranë për ta mbështetur dhe ndihmuar, por unë jam i sigurt se ai do të marrë shumë dashuri sepse ka luajtur shumë mirë", ka shtuar trajneri Southgate.

Chiellini: Nga muaji maj kemi ndier që ka diçka magjike në ajër

LONDËR, 12 KORRIK - Italia e fitoi trofeun e dytë të Evropës pasi në finale e mposhti Anglinë. Koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan me rezultat 1-1, kurse në penallti fituan italianët me rezultat 3-2. Kapiteni Giorgio Chiellini ka thënë se nga fundi i muajit maj e kanë ndier diçka magjike në ajër. "Më ranë lotët. Të gjithë e meritonim që ta fitonim trofeun. Në këtë moshë



kuptohet më shumë se çfarë do të thotë të fitosh një trofe si ky. Që nga fundi i majit ne kemi ndier që ka diçka magjike në ajër. Ditë pas dite ka qenë gjithnjë e më shumë e pranishme kjo ndjesi. Sirigu na bëri një surprizë para ndeshjes. Kishte përgatitur një video të gjithë familjarëve tanë dhe na bëri të qajmë në autobus para ndeshjes", ka thënë Chiellini.

Kane: Penalltitë janë ndjenja më e keqe në botë

LONDËR, 12 KORRIK - Kapiteni i Anglisë, Harry Kane, ka thënë, pas humbjes në finale të Kampionatit Evropian, se penalltitë janë ndjenja më e keqe në botë, kur humb ndeshjen", ka thënë Kane për BBC. Kane ka thënë se bën një turne mjaft të mirë dhe se duhet të jenë krenarë për lojën e bërë. "Ka qenë një turne fantastik. Duhet të



jemi krenarë, të mbajmë kokën lart. Do të jetë e dhembshme tani, dhe do të dhembë për një kohë", ka shtuar Kane.


Ronaldo: Faleminderit të gjithëve që më ndihmuan të arrij një tjetër çast historik

LISBONË, 12 KORRIK - Cristiano Ronaldo është shpallur golashënuesi më i mirë në Kampionatin Evropian "Euro 2020" pavarësisht që

kombëtarja e tij u eliminua në fazën 1/16 e finales. Me pesë gola dhe një asistim të regjistruar, Ronaldo ishte golashënuesi numër një në

këtë "Euro 2020", turne që u fitua nga Italia. Ndërsa së fundmi, pesë herë fituesi i Topit të Artë ka reaguar në rrjetin social "Instagram", duke

falënderuar të gjithë që i ndihmuan të arrij këtë rekord. "Faleminderit të gjithëve që më ndihmuan të arrij një tjetër çast historik", ka shkruar Ronaldo.



Donnarumma shpallet lojtari më i mirë i 'Euro 2020', Ronaldo golashënuesi më i mirë

LONDËR, 12 KORRIK - Gianluigi Donnarumma është zgjedhur lojtari më i mirë i Kampionatit Evropian "Euro 2020". Portieri Donnarumma ishte heroi i Italisë pasi i prit dy prej pesë goditjeve të anglezëve para 66 mijë tifozëve në "Wembley",

për ta kthyer titullin evropian në Itali pas plot 53 vjetëve. Donnarumma i prit penalltitë e Jadon Sancho dhe Bukayo Saka, ndërsa Marcus Rashford e goditi shtyllën pingule. Donnarumma kishte qenë crucial edhe në gjysmëfinale

ku kishte arritur të presë dy penallti për ta dërguar Italinë në finale. Donnarumma është, po ashtu, edhe "lojtari më i mirë në Euro 2020". "Lojtari më i mirë i ndeshjes" u shpall mbrojtësi i Italisë, Leonardo Bonucci.

Golashënues më i mirë në këtë turne është shpallur Cristiano Ronaldo me 5 gola dhe një asistim. Pesë gola i ka shënuar edhe Patrick Schick, por Ronaldo e fiton këtë çmim në saj të një asistimi që ka më shumë se çeku.



Milwaukee ngushton epërsinë e fitoreve ndaj Phoenixit

MILWAUKEE, 12 KORRIK - Milwaukee Bucks e ka rihapur serinë e finales së madhe të NBA ndaj Phoenix Suns. Në "Fiservforum" në Wisconsin skuadra e drejtuar nga Mike Budenholzer triumfoi lehtësisht me rezultatin 120-100 ndaj formacionit nga Arizona duke e ngushtuar në 2-1 me ndeshje serinë e përballjeve mes tyre. Vetëm në periodën e parë Phoenixi ishte më lart se Bucks duke e mbyllur në avantazhin e tri pikëve sepse më pas sfida kishte vetëm një drejtim dhe u dominua nga Giannis Antetokounmpo me shokë. Greku ishte fantastik në këtë përballje duke udhëhequr Milwaukee me 41 pikë, 13 rebounde dhe 6 asistime drejt një triumfi shumë të rëndësishëm. Bucks shfaqti versionin e tyre më të mirë në periodën e dytë të ndeshjes të cilën e mbylli me një rezultat të pjesshëm 35-17 në favor dhe pikërisht ky 12-minutësh vendosi fatet e takimit. Përveç Giannis Antetokounmpo për Milwaukee u paraqitën mirë në këtë duel të tretë ndaj Phoenixit edhe Jrue Holiday,



autor i 21 pikëve dhe Khris Middleton, që shënoi 18 pikë. Për skuadrën e trajnerit Monty Williams nuk shfaqti versionin e saj më të mirë treshja Davon Booker-Chris Paul-DeAndre Ayton. I pari e mbylli ndeshjen me vetëm 10 pikë, ndërkohë që Chris Paul dhe DeAndre

Ayton realizuan respektivisht 19 dhe 18 pikë. Edhe finalja e katërt mes Bucksit dhe Sunsit do të zhvillohet në Milwaukee me skuadrën e Mike Budenholzerit që është e avantazhuar pasi deri tani diferencën në serinë mes tyre e ka bërë parketi.

Daci: Është nder të luash për Kosovën

PRISHTINË, 12 KORRIK - Basketbollistët e Kosovës A po vazhdojnë përgatitjet për garat ndërkombëtare. Kosova A te femrat për herë të parë do të garojë në arenën ndërkombëtare, ku do të marrë pjesë në Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla. Kampionati mbahet nga 20 deri më 25 korrik në Qipro. Qendra pejane, Saranda Daci, ka folur për rëndësinë që ka formimi i Përfaqësueses A dhe pjesëmarrja në garat evropiane. "Jemi shumë të lumtura që jemi pjesë e Kosovës. Kemi një ekip të kombinuar me lojtare me përvojë, por edhe të reja, që premtojnë shumë. Për shumë lojtare është një ëndërr e realizuar, sepse nuk kemi pasur mundësinë të garojmë më herët, pasi Kosova nuk ishte e pranuar. Për ne është nder dhe krenari", ka thënë Daci për faqen zyrtare të FBK-së. Ajo ka folur edhe për rrjedhën e përgatitjeve. "Jemi duke u stërvitur maksimalisht dhe kemi zhvilluar një



miqësore me Shqipërinë U20. Shpresoj se gjithçka do të shkojë sipas planit deri në fund", ka shtuar 28-vjeçarja. Kosova është në grup me Qipron dhe Luksemburgun. "Ne shpresojmë në

paraqitje të mira, sepse është hera e parë që luajmë në një ngjarje ndërkombëtare. Do të mundohemi të japim më të mirën tonë, pasi e dimë rëndësinë e pjesëmarrjes", ka deklaruar Daci.

SHKURT

KB Ylli 'blindon' Kastratin

Basketbollisti Erjon Kastrati do të jetë pjesë e skuadrës së Golden Eagle Ylli edhe për dy vjet të tjera. Lajmin e ka bërë me dije skuadra kampione nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare. "Erjon Kastrati edhe për dy vjet lojtar i Golden Eagle Yllit", thuhet në njoftimin e KB Yllit. Erjon Kastrati është një ndër më meritoret për suksesin e Yllit në Superligë dhe Ligën Unike.

Emini konfirmon largimin nga Flamurtari

Futbollisti i njohur Leart Emini është larguar nga skuadra e Flamurtarit. Ka qenë vetë Emini që e ka konfirmuar ndarjen me klubin kuqezi nga kryeqyteti. "Ju njoftoj se nga sot nuk jam pjesë e KF Flamurtari. Marrë parasysh si rrodhën të gjitha ngjarjet, Flamurtari është klubi ku nisa hapat e parë si futbollist dhe në të ardhmen i dëshiroj suksese dhe të gjitha të mirat", ka shkruar Emini në profilin e vet në "Facebook".

Pedri, talenti më i mirë i 'Euro 2020'

"Euro 2020" u mbyll tashmë me Italinë fituese dhe radhën e kanë çmimet e më të mirëve të turneut. Lojtari më i mirë u shpall Gianluigi Donnarumma, ndërsa Cristiano Ronaldo doli golashënuesi më i mirë. Ndërkohë Pedri Gonzales, ylli i Spanjës në këtë Evropian, meritoi çmimin e lojtarit të ri më të mirë të turneut. 18-vjeçari ishte i jashtëzakonshëm për Spanjën dhe humbi vetëm një minutë në 6 ndeshjet e Spanjës në këtë turne. Ai kishte luajtur vetëm katër ndeshje për Spanjën para Euro 2020, teksa gjatë gjithë sezonit ishte titullar absolut nën drejtimin e Ronald Koeman te Barcelona. Një yll i ri ka lindur në Spanjë, pasi Iniesta e Xavi mbyllën epokën e tyre të lavdishme.

Halimi transferohet te Riga

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Besar Halimi ka arritur marrëveshje me klubin nga Letonia, FC Riga. Halimi do ta vazhdojë karrierën në Letoni te skuadra e Rigës. Mesfushori nga Kosova në dy sezonet e fundit ishte pjesë e Saundhasen në Bundesliga 2. 26-vjeçari është pjesë e Kombëtares së Kosovës, ndërsa në të kaluarën, përveç për Gjermaninë, ka luajtur edhe në Danimarkë për skuadrën e Brøndby. Lajmin për transferimin e Halimit në Letoni e ka dhënë vetë klubi i Rigës në llogarinë e vet në "Facebook".

Italia "fluturon" në renditjen e FIFA-s

Italia u shpall kampione e Evropës duke mundur Anglinë në finale në shtëpinë e këtyre të fundit në "Wembley". "Axurrët" kanë marrë një hov të

pabesueshëm në vendin e futbollit botëror duke u ngjitur në vendin e katër në renditjen botërore të kombëtareve. Italia renditet pas Belgjikës, Francës

dhe Brazilit dhe kjo do të jetë shumë e rëndësishme për Botërorin e ardhshëm pasi "axurrët" do të pozicionoheshin në vazon e parë për fazën e

grupeve. Në vitin 2018 Italia renditej në vendin e 20 duke mos arritur të kualifikohej dot as në Kupën e Botës, por arkitekt Mançini transformoi skuadrën

duke e shpallur kampione të Evropës. "Axurrët" kanë fituar edhe një shumë të konsiderueshme nga turneu, plot 28.2 milionë euro.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Automekanik - Njësia në Skenderaj , i Konkursit të shpallur me datë 10.06.2021

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **13.07.2021**. deri me date **19.07.2021** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Hekraria Konxheli" Sh.p.k. Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën grumbulluese, çmontuese të automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre dhe mbeturinave metalike në Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.08.2021 në ora 09:00 në hapësirat e Restortant&Pizzeria „SELECT” Rruga Hasan Prishtina, në Obiliq do të organizohet debat publik nga Kompania "Hekraria Konxheli" Sh.p.k. Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën grumbulluese, çmontuese të automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre dhe mbeturinave metalike në Obiliq

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us02web.zoom.us/j/81489135906?pwd=NXpiRVBqQiBueithU21sN0RHSGV4Zz09>

Meeting ID: 814 8913 5906

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Hekraria Konxheli" Sh.p.k. Obiliq, për qendrën grumbulluese, çmontuese të automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre dhe mbeturinave metalike në Obiliq

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Pesë (5) Punëtor Fizik - KRM "Uniteti"Sh.A Njësia në Skenderaj - i Konkursit të shpallur me datë 10.06.2021

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **13.07.2021**. deri me date **19.07.2021** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Freskimi Group" Sh.p.k. Greikoc, Suharekë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit në Greikoc, Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.08.2021 në ora 11:00 në Restourant: N.Sh. "FRESKIMI" Adresa; Rr. Ymer Prizreni, Gelance Therande, do të organizohet debat publik nga Kompania " Freskimi Group" Sh.p.k. Greikoc, Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit në Greikoc, Suharekë

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: 1YsD3f

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " Freskimi Group" Sh.p.k. Greikoc, Suharekë, për bazën për prodhimin e betonit në Greikoc, Suharekë.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



INVITATION TO TENDER

The Business Support Center Kosovo – BSCK is implementing one of the project Support to Employment of Youth in Energy Sector The project is funded by European Union an implemented by BSCK. BSCK invites Bidders to submit, free of charge, and without obligation on part of BSCK, a bid on offering tailored Home Automation and Video-Citophony Electrical Panels for Professional Public Schools which will contribute directly to project activity A.2.1. Piloting of new curricula by certified trainers in three electrical modules, and help students grasp the concepts of home automation.

Interested bidders can send a request for Terms of Reference via email with reference number BSCK/2020/419-482 in the subject line to info@bsckosovo.org.

The responsible BSCK officer will provide you with Terms of Reference (along with Home Automation Electrical Panels specifications, and application procedure) within a day.

Bidders are not allowed to contact or discuss any aspect of the tender with BSCK before closing of the tender as it will lead to automatic disqualification.

Request for Terms of Reference must be sent by e-mail to info@bsckosovo.org before 19 July, 2021.

Application deadline is on 26 July, 2021 at 16:00



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI JURIDIK

Studimet Post-diplomike të Doktoratës

Në bazë të Nenit 127 al. 1 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nenit 17 al. 2 dhe 4 të Rregullores mbi studimet e doktoratës, Vendimit nr. 03/93 nga mbledhja e Këshillit të Fakultetit Juridik të datës 16.02.2021, si dhe vendimit për ratifikimin nga Senati i UP, nr. 551 të datës 15 prill 2021, kandidatës Ma.sc. Luljeta Plakolli-Kasumi i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të cekura më lartë, bëjmë këtë:

NJOFTIM

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit se me datën 19 korrik, 2021, me fillim në ora 10.00, në Amfiteatrin e madh të Fakultetit Juridik të UP-së, kandidatja për fitimin e titullit doktor i shkencave juridike, nga fusha: Civilo-juridike, Luljeta Plakolli-Kasumi bën mbrojtjen publike të disertacionit me titull: **"Klauzola e Arbitrazhit në Kontratat në mes Bizneseve dhe Konsumatorëve: Udhëzimi i UE-së mbi Kushtet e Padrejta Kontraktore, dhe Zbatueshmëria e Kësaj Klauzole nga Gjykatat e Republikës së Kosovës"**, para komisionit profesional, me këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Sc. Enver Hasani (Kryetar)
2. Prof. Asist. Dr. Bedri Bahtiri (anëtar)
3. Prof. Asoc. Dr. Flutura Kola- Tafaj (anëtare e jashtme nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës)

Prishtinë me 12 korrik, 2021

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " DP&Partners" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e betonit në Fushë Kosovë . Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.08.2021 në ora 10:00 në Restorantin e kompanisë HIB Petroll , që gjendet në anën e djathtë të autostradës Fushë Kosovë-Prizren në kilometrin e tretë nga rreth rrotullimi i Fushë Kosovës në drejtim të Sllatinës do të organizohet debat publik nga Kompania " DP&Partners" Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për prodhimin e betonit në Fushë Kosovë. Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJlCUT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " DP&Partners" Sh.p.k. Prishtinë, për prodhimin e betonit në Fushë Kosovë https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "3 MIX" SH.P.K. me nr. 810774655 bënë zvogëlim të kapitalit nga 950.000.00 në 5.000.00.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULË

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues